



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORË

DREJTORIA E PRONAVE PUBLIKE DHE MENAXHIMIT TE ASETETEVE

Nr. 10855 / Prot

Vlorë, më 26.07 2024

Lënda: Mbi pyetjet e parashtruara në E-mail-in e dërguar.

**Z.IVAN BLLAZHEVSKI**

**GAZETAR IRL (Investigative Reporting Laboratory-Macedonia)**

Në përgjigje të E-mail me subjekt "Pyetje nga Shkupi", Drejtoria e Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve ju sqaron dhe informon si vijon:

Pranë DPPMA, është përcjellë Leje Infrastruktura Nr.545 date 25.09.2020 me objekt "Lidhja e Rruges Transballkanike me Portin Detar Vlorë" dhe projekti i zbatimit.

Në bazë të Ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, Ligjit nr.8561, date 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik", i ndryshuar, VKM-së nr.138, datë 23.03.2000 "Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive pronë private që shpronësohen dhe të drejtave të personave të tretë, për interes publik", i ndryshuar, subjekti kërkues Bashkia Vlorë, ka përgatitur dokumentacionin ligjor dhe teknik për të realizuar procedurën e shpronësimit për pasuritë e paluajtshme, sipërfaqet, ndërtesat dhe objektet e banimit, etj., që preken nga realizimi i këtij projekti publik, bazuar në statusin juridik të pasurive që preken nga gjurma e projektit të konfirmuara nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës Vlorë. Bashkia Vlorë, ka përcjellë kërkesën për shpronësim së bashku me të gjithë dokumetacionin ligjor dhe teknik në Agjencinë Shtetërore për Shpronësim pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë Tirane.

Mënyra e vlerësimit për pasuritë me status juridik privat, që janë prekur nga gjurma e projektit, është bazuar në VKM Nr.138, datë 23.3.2000 "Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive pronë private që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të drejtave të personave të tretë, për interes publik". Konkretisht:

- Vlerësimi i pasurisë së llojit “truall” , është llogaritur bazuar në VKM 89 Date 03.02.2016 të Këshillit të Ministrave “Per miratimin e hartes se vleres se tokes ne Republiken e Shqiperise” , ne te cilen eshte percaktuar cmimi perkates sipas zk. Në 8604, Vlora 4, çmimi është 6,899 leke/m2.
- Vlerësimi për objektet e banimit bazuar ne pikën 2 të VKM 138/2000, përcaktohet si mesatare e shitblerjeve nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës. ASHK Vlorë ka përcaktuar çmimin 52,296 leke/m2 për pasuritë e llojit “apartament”.
- Vlerësimi për objektet e llojit jo banim, është përllogaritur me metoden e kostos së ndërtimit.

Në vijim MIE Tiranë, ka shpallur njoftimin për shpronësimin publik dhe pas plotësimit të afateve ligjore për ankimmimet është miratuar V.K.M nr.20, datë 17.01.2024 “Për shpronësimin për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private që preken nga realizimi i projektit “Lidhja e rruges Transballkanike me Portin Detar” Vlorë, botuar ne fletoren zyrtare.

Subjektete e shpronësuara sipas kësaj VKM –je kane depozituar kërkesat dhe dokumentacionin përkatës për likuidim.

Nga ky proces, sot rezultojnë tre kenë marrë vlerën e shpronësimit 30 subjekte dhe 3 subjekte të tjera janë në proces.

17 subjekte nuk kanë paraqitur dokumentacionin për likuidim.

Janë në proces hipotekimi nga ASHK 6 subjekte, për të cilët sapo të përfundojë regjistrimi i pasurive ,DPPMA do të aplikojë në ASHSH , MIE Tiranë , kërkesën për shtesë VKM-je.

Për 1 subjekt ka përfunduar procedura e privatizimit, por subjekti megjithë njoftimin e bërë,ende nuk është paraqitur në Bashki për të vijuar me regjistrimin e pronës.

Në pritje për shtesë VKM –je janë edhe 2 subjekte.

Pra gjithsej jane 9 subjekte për kërkesë për shtesë VKM-je, pas plotësimit me dokumentacion pronësie.

Ju faleminderit !

**KRYETAR**

**Ermal Dredha**

**ME URDHËR DELEGIMI**

**NËNKRYETAR**

**Klevis Kaso**

